REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës:	2020:043877
Datë:	03.06.2020
Numri i dokumentit:	00940661

P.nr.274/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Ylberza Gllogjani, në lëndën penale kundër të pandehurit F Z nga P, i akuzuar për vepër penale të *kanosjes* nga neni 181 par. 3, të KPRK-se, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Pejë –Departamentit i Përgjithshëm, PP.II.nr.499/20 te datës 14.04.2020, në seancën publike të shqyrtimit fillestar, të mbajtur me date 16.04.2020, në praninë e Prokurores së Shtetit Sadije Muriqi, të pandehurit dhe mbrojtësin e tije av. Gëzim Kollqakut, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 04.05.2020, përpiloi këtë :

A K T GJ Y K I M

I pandehuri:

F Z, i lindur më ..., me numër ..., i biri i SH Z dhe nënës S Z, e gjinisë S , me vendbanim në Pejë, Rr. B E K Nr.... i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer 8 vite të shkollës fillore, i martuar, punon si auto ngjyresës, realizon te hyra mesatare nga puna 500-600 euro, ka qenë në paraburgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditësh për këtë vepër penale nga data 26.03.2020 e gjerë me datën 16.04,2020, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, të njëjtën ditë ju ka ndërpre paraburgimi qe të mbrohet në liri, përderisa aktgjykimi të merre formën e prerë.

Duke u bazuar në nenin 365 par 1, te Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri, *F Z*

SHPALLET FAJTOR

2020:043878

Për shkak se:

Me date 26.03.2020, rreth orës 17:20, në Rr. " ...", mu në Stacionin Policor në Pejë , seriozisht kanos të dëmtuarin – rreshterin Hasna Buqja, në mënyrë që, ditën kritike pasi që i pandehuri pasi lirohet në procedura të rregullt rreth orës 16:45 sipas aktvendimit nën RLN/I Nr.17/2020 të datës 25.03.2020(i lëshuar nga PTH-Pejë, Departamenti për Krime të Rënda)ku më pas kthehet përsëri në Stacionin policor dhe pas zhvillimit të nja bisede më të dëmtuarin para objektit i drejtohet me fjalët kanosëse *"kur të zhveshës uniformen ki me pa ti dhe se këna me pa për qetë punë"*, po ashtu pasi që i njëjti arrestohet kalon në zyrën e hetimeve përsëri e kanos të dëmtuarin me fjalët kanosëse "o ve mos e zhveshësh ti kurrë këtë uniformë se ki me pa ti se kush jam unë , ki me ma pa sherrin në kofsha gjallë, se je ka done mëmë marr në qafë".

- me çka ka kryer vepër penale *kanosje* nga neni 181 par.3 te KPRK-së

Andaj, Gjykata komfor nenit 7, 8, par.1,9, 10 par.1, 17 par.1, 21, 38,39,40, 42 par.1.1,44. par.1,2, 69,70, dhe 181 par.3, të KPRK-së, dhe nenit 285,359,360, 361,365, 366, 453, të KPRK-së, të pandehurin F Z e :

G J Y K O N

1. **Denim me burgimi** në kohëzgjatje prej /6/ gjashtë/muajsh/ne te cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 26.03.2020 e deri me dt: 16.04.2020.

2. **Dënimi me burgim sipas pikës 1**, me pëlqimin e të pandehurit e në përputhje me nenin 44 , i është zëvendësuar me dënim me gjobe në shumë të përgjithshme prej 600(gjashtëqind / euro, për gjithsejtë 160 ditë, ekuivalent për çdo ditë burgimi nga 20 euro, pa njëzet ditë të paraburgimi të mbajtura.

3. **Dënimi me gjobë në shumë prej 600(gjashtëqind / euro**, do te ekzekutohet në afat prej 90 dite, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari, nuk e ekzekuton dënimin me gjobë, apo e refuzon ekzekutimin, atëherë dënimi me gjobë zëvendësohet me burg në kohëzgjatje prej 30(tridhjetë) ditësh, e duke llogaritë 20 euro, për një ditë qëndrimi në burgim .

5. **Obligohet,** i pandehuri qe në emër të shpenzimeve procedurale te paguaj shumen prej 30 euro, ndërsa në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit.

6. Të pandehurit, i ndërpritet masa e paraburgimit menjëherë nga data 16.04.2020, për tu mbrojtur në liri.

7. **I dëmtuari**, H B, udhëzohet në kontest civil, për realizimin e kërkesës-pasurore- juridike.

2020:043878

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, ka ngritur akuzë PP.nr.499/2020, të dt. 14.04.2020, ndaj te pandehurit F Zaboit nga P, për shkak te veprës penale të kanosjes nga neni 185 par. 3 te KPK-ës.

Gjykata, fillimisht ka vërtetuar se ka kompetencë në pikëpamje lëndore dhe territoriale për të gjykuar këtë çështje penale, ngase vepra penale për të cilat akuzohet i pandehuri F Z, rezulton të jetë kryer në territorin e Gjykatës Themelore në Pejë, si dhe vepra penale–e kanosjes nga neni 181 par.3 te KPK-ës, sipas ligjit bie në kompetence lëndore të departamentit të përgjithshëm, ngase për këtë vepër penale përcaktohet dënimi deri ne /3/tri/ vjet burgim.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 16.04.2020, në pranin e prokurorit të shtetit të pandehurit F Z i cili është sjella nga qendra e paraburgimit të Pejës nënë shoqërimin policor, e ku prezent ishte edhe avokati i tij me autorizim Gëzim Kollçaki.

Pas leximit te aktakuzës nga ana e prokurorit, i pandehuri u deklarua fajtor për veprën penale me te cilën akuzohet.

Pas deklarimit te pandehurit, mendimit te prokurorit dhe mbrojtësit të pandehurit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit te fajësisë, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 te KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë ne ketë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit F Z, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale *kanosje* nga neni 181 par. 3 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer. Gjatë procedurës penale nuk janë

2020:043878

paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese ne kuptim te nenit 70 te KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për te pandehurin, gjykata ka vlerësuar sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor fillestar, duke pranuar fajësinë, e të cilin pranim e kishte bërë edhe në Prokurori e duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij, duke premtua se ne të ardhmen s'do të përsëris veprime të tilla. Si rrethana rënduese për te pandehurin gjykata gjeti se i njëjti kishte qenë i dënua për lëndim të lehtë trupor në këtë gjykatë sipas deklarimit të tije.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim te nenit 70 te KPRK-se te pandehurin e gjykoi si ne diapozitiv te këtij aktgjykimit, me te cilin do te arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te pandehurit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 te KPPRK-se.

Vendimin për zëvendësimin e dënimit me burgim prej 6 (gjashtë) muajsh, përshkruar sipas pikës 1, duke hequr ditë e paraburgimit nga data nga data 26.03.2020 e deri me dt: 16.04.2020, në dënim me gjobë në shumë prej 600 euro, përshkruar në piken 2, të dispozitivit të aktgjykimit, u mor me pëlqimin e të pandehurit e në përputhje me nenin 44 par.1, të KPRK-ës, përderisa,

Vendimi, mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë, në dënim me burgim në rast dështimi për paguarjen të gjobës, e morri në përputhje me nenin 43 par. 3 të KPK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, ndërsa

Në emër të kompensimit të viktimave Gjykata e obligoi të akuzuarin ta paguaj shumën prej 30 €, komfor dispozitës së nenit 39 par. 1, 2, 3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave.

Gjykata me vendime të veçant ja ka ndërpre masa e paraburgimit, në përputhje me nenin 185 par.3 të KPK-ës, pasi qe kanë pushuar shkaqet e caktimit të tij.

Konform nenit 463 par. 3 te KPPRK-se, pala e dëmtuar H B, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar ne kontest civil.

2020:043878

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.274/20 më datë 04.05.2020

Zyrtarja Ligjore,
Ylberza Gllogjani

Gjyqtari Gjykues,
Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate

2020:043878